



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:000205
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05419373

C.nr.4717/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.G.me numër personal ... me vendbanim në fshatin Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson B.L. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 2,262.03, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor-publik, në prani të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 04.03.2024, mori, ndërsa me datë 06.03.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit B.G. nga fshati Komuna e Suharekës, ashtu që **DETYROHET** e paditura, Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, që paditësit B.G. nga fshati Komuna e Suharekës, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 2,262.03 € (dymijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy euro e tre cent), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (datë 05.01.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 519.00 € (pesëqind e nëntëmbëdhjetë), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

1. Historiku i çështjes dhe Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi B.G. nga fsh Komuna e Suharekës, përmes të autorizuarit të tij Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilarë.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka marrë aktgjykimin me shenjë C.nr.13/2022, të datës 20.09.2022, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit B.G. nga fshati Sallagrahdë, komuna e Suharekës, si në këtë aktgjykim. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjore ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin me shenjë Ac.nr.7126/2022, të datës 21.11.2023, e ka aprovuar si të themeltë ankesën e të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, është prishur aktgjykimi i gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.13/2022, i datës 20.09.2022 dhe lënda i është kthyer të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Duke vepruar sipas Aktvendimit me shenjë Ac.nr.7126/2022, të datës 22.11.2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prizren ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin kryesor, në të cilin janë marrë parasysh dhe është vepruar sipas vërejtjeve të dhëna sipas aktgjykimit të lartcekur.

Edhe gjatë shqyrtimit të mbajtur pas kthimit të çështjes në rigjykim, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë, respektivisht precizimit të padisë të bërë me parashtresën e datës 02.06.2022, duke konsideruar për dispozitat ligjore të ligjit të punës dhe kontratës së punës së shëndetësisë e paditura nuk i ka kryer detyrimet e saj konform dispozitave ligjore. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi i kërkon tri paga jubilarë në bazë të kontratës sepse ka përmbushur 30 vite përvojë pune dhe kjo argumentohet sipas listës së pagës. Kjo e drejtë bazohet në nenin 17 par.3.3 të kontratës kolektive të shëndetësisë të vitit 2018, e cila nuk bjen në kundërshtim edhe sipas mendimit juridike të Gjykatës Supreme, duke konsideruar se pas administrimit të provave është konstatuar se e paditura detyrohet paditësit që në emër të tri pagave jubilarë ti paguaj shumën 2,262.03 euro dhe atë me kamatë ligjore 8% ,nga parashtrimi i padisë deri në pagesën definitive. Në fund gjykatës i ka kërkuar që pas administrimit të provave të aprovohet padia dhe kërkesë padia e paditësit në tërësi si e bazuar. Gjithashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilimin e padisë 104 euro, për përfaqësim në dy seanca secilën nga 135 euro, parashtrimi i përgjigjes në ankesë shumën prej 208 euro, si dhe taksën gjyqësore 41 euro, gjithsej në shumë prej 623 euro, bazuar në tarifën e OAK.

Edhe gjatë shqyrtimit të mbajtur pas kthimit të çështjes në rigjykim, i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë përgjigjes në padi, ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se kërkon nga gjykata që kërkesën për tri paga jubilarë të refuzoj si të pa bazuar dhe të marr parasysh se kemi të bëjmë vetëm me një pagë jubilarë, gjithashtu i ka kundërshtuar të gjitha shpenzimet gjyqësore, sepse pala paditëse është dashur me kohë të i kërkojë shumat duke u bazua në pagën bazë e jo siç e ka kërkuar pagën ku janë përfshirë edhe shtesat tjera si kujdestaritë. Nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

2. Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Kontratën e punës për kohë të pa caktuar me nr. 664 e lidhur me datë 06.12.2012, në mes të punëdhënës Spitali Rajonal “Prim.Dr. Daut Mustafa” në Prizren e përfaqësuar nga Dr. M.K. drejtor në anën tjetër si punëdhënës dhe B.G. në anën tjetër si punëmarrës; kontratën e punës për kohë të caktuar me nr. të kontratës: 664, në mes të punëdhënës Spitali Rajonal “Prim.Dr. Daut Mustafa” në Prizren e përfaqësuar nga Dr. M.K. drejtor në anën tjetër si punëdhënës dhe Bali Gashi, në anën tjetër si punëmarrës; vërtetimin me nr. AMZ.664, mbi përvojën e punës, të lëshuar nga Spitali Rajonal “Prim.Dr. Daut Mustafa” në Prizren, të datës 31.05.2022, në emër të paditësit; listën e pagës me nr. EM00031579, të datës 31.05.2022, të lëshuar nga e paditura për paditësin; ankesën e datës 01.09.2021, të ushtruar nga ana e së paditurës Spitali i Përgjithshëm Rajonal në Prizren, kundër vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, me nr.PPP.nr.653/2020, të datës 27.08.2021 dhe numër të Smilit 2020:121535; listën e pagave me nr. EM00031579, për paditësin B.G.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit **është në tërësi e bazuar.**

Nga kontrata e punës, me numër 664, e datës 06.12.2012, Titulli i Postit H-20, e lidhur mes Spitalit Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren dhe B.G. gjykata vërtetoi faktin se është lidhur kontrata e punës me kohë të pacaktuar për këtu paditësin B.G. Sipas kësaj kontrate i punësuar do të kryej detyrat e Otorinolaringologë në Repartin e Otorinolaringologjisë. Këtë pozitë i njëjti e ka filluar nga data 01.01.2013.

Nga kontrata e punës, me numër 664, Titulli i postit H-15, e lidhur mes Spitalit Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren dhe B.G. gjykata vërtetoi faktin se është lidhur kontrata e punës me kohë të pacaktuar për këtu paditësin B.G. Sipas kësaj kontrate i punësuar do të kryej detyrat në Repartin e ORL-së, si shef i Repartit. Kjo pozitë i është caktuar nga data 01.01.2020 deri me datën 31.12.2022.

Nga vërtetimi me numër amz.664, i datës 31.05.2022, të lëshuar nga Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi B.G. Otorinolaringolog, është në marrëdhënie pune në Spitalin Rajonal “Prim.Dr. Daut Mustafa” në Prizren. Paditësi ka filluar punën nga data 23.01.1989 deri më 31.05.2000, pastaj nga data 01.10.2001, ku vazhdon ende të punojë. Sipas këtij vërtetimi paditësi ka 31 vite, 11 muaj dhe 6 ditë përvojë pune, e cila është llogaritur deri me datë 30.04.2022, ndërsa paga bazë e tij është 754.01 euro.

Nga lista e pagave me nr.EM00031579, për periudhën prej datës 01.05.2022 deri më datë 31.05.2022, të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.G. rrogën bazë e ka në shumën prej 754 (shtatëqind e pesëdhjetë e katër) euro, si dhe përvoja e punës në institucionet shëndetësore për këtu paditësin, është 32 vite.

Nga ankesa e datës 01.09.2021, kundër aktvendimit me numër PPP.653/2020, të datës 27.08.2021, me numër të Smilit 2020:121535, gjykata vërtetoi faktin se e paditura Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, ka paraqitur ankesë ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, me të cilin është hedhur prapësimi i debitorit-këtu të paditurës, i ushtruar ndaj Urdhërit Përmbarrimor për lejimin e Përmbarrimit P.nr.2396/2020, të datës 17.07.2020. Sipas kësaj ankese, me anë të aktvendimit të atakuar, këtu paditësit i është njohur e drejta për dy paga jubilarë, përkatësisht për 20 vite përvojë pune.

Gjykata ka bërë leximin e listës së pagave me nr. EM00031579, për paditësin B.G. sipas të cilit konstatohet se paditësi .B.G. pagën mujore bazë e ka në lartësi prej 754 euro.

3. Baza ligjore

Sipas nenit 4 par. 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (LP), në mënyrë decisive përcaktohet se “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Po ashtu, në nenin 90 par. 5 të LP-së, theksohet që “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Pastaj, në bazë të nenit 78 të LP-së, parashihet e drejta e të punësuarit që të kërkoj nga punëdhënësi për realizim të ndonjë të drejte dhe punëdhënësi është i obliguar që të vendos lidhur me një kërkesë të tillë. Në vazhdim, me nenin 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet e drejta e të punësuarit që të kërkoj mbrojtje gjyqësore në Gjykatë Kompetente lidhur me vendimin apo mos veprimin e punëdhënësit lidhur me ndonjë kërkesë së të punësuarit.

Me nenin 17 par.3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, të dt.12.06.2018, është paraparë se “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: “për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të tre paga mujore të tij”, ndërsa në par. 4 të këtij neni thuhet se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Ndërsa neni 17, par.4, i kontratës së lartcekur përcakton se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga të gjitha faktet dhe provat e administruara, për palët nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune pranë paditëses-Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren. Ndërsa, kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj, përkatësisht nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit në shpërblimin jubilar.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtorë në institucionin shëndetësor, t'ia paguaj kompensimin për shpërblimin jubilar, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale, me numër të njësisë 01, numër të prot.05-3815, të datës 12.06.2018, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Kjo duke u bazuar edhe në vërejtjet e Gjykatës së Apelit, provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore dhe precizimit të bërë nga i autorizuari i paditësit.

Në bazë të provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata vlerësoi se e paditura duhet ti paguan paditësit B.G. në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, shumë prej 2,262.03 €. Kjo duke u bazuar në nenin 17 par 3, nën par.3.3, të kontratës së lartcekur, pasi që për të njëjtin kërkesa kompensimin e shpërblimit jubilar është bërë e arritshme, konkretisht për 30 vite përvojë pune, tri paga mujore të tij. Si dhe duke u bazuar në Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023, në pikë V, përcaktohet që kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që *“punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore të punëdhënësi i fundit”*. Paditësi B.G. nga Prizreni, pranë të paditurës i ka 31 vite, 11 muaj dhe 6 ditë përvojë pune (bazuar në vërtetimi me numër të protokollit 664, të datës 31.05.2022, të lëshuar nga Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, kontratave të punës të lidhura në mes të paditësit si i punësuar dhe të paditurës si punëdhënëse, si dhe nga lista e pagave), e cila përvojë është llogaritur deri me datë 30.04.2022, me çka mund të konstatohet se i njëjti 30 vite të përvojës së punës i ka arritur gjatë vitit 2020, në kohën kur ka qenë në fuqi kontrata kolektive sektoriale dhe paga mujore e tij ka qenë në lartësi prej 754.01 €. Andaj edhe kërkesëpadia e paditësit është aprovuar në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumë përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (05.01.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, se për dy paga jubilarë të paditëses është duke u zhvilluar procedura përmbartimore sipas ankesës pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, edhe se të njëjtit i takon vetëm edhe një pagë jubilarë, erdhi në përfundim se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë. Sipas gjykatës procedura pranë organit përmbartimor është duke u zhvilluar lidhur me të drejtën në shpërblim jubilar për dy paga në bazë të kërkesës për 20 vite përvojë pune, ndërsa kërkesa në këtë çështje kontestimore ka të bëjë lidhur me realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar për 30 vite përvojë pune bazuar në nenin 17, par.3 nën par.3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, me numër të njësisë 01, numër prot.05-3815, të datës 12.06.2018, si dhe bazuar në Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar të Gjykatës

Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023, ku është paraparë se “*Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: ... për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të tre paga mujore të tij*”.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse dhe provat materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Në kuptim të dispozitave të nenit 420 par.3 të LPK-së, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, menjëherë pas mbajtjes së seancës përgatitore, pas propozimit të vet palëve ndërgjyqëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463.1 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet taksës gjyqësore në shumën prej 41.00 euro, përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore në shumën prej 270.00 euro (2x135), për përpilimin e përgjigjes në ankesë shumën prej 104.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 519.00 € (pesëqind e nëntëmbëdhjetë).

Gjykata gjeti si pjesërisht të bazuar kërkesën e paditësit që lidhur me kompensimin e shpenzimeve gjyqësore për përpilimin e përgjigjes në ankesë ti kompensohet shuma prej 208.00 €, pasi që bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve, kompensimi për përpilimin e parashtrësive në procedurë civile, tek kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 €, është paraparë në lartësi prej 104.00 €.

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:000205, 06.03.2024

G j y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.